

URDHËR
Nr.502, datë 7.10.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS, NË
AKADEMINË E MBROJTJES “SPIRO MOISIU” TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor””, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, në “Fusha e sigurisë dhe e mbrojtjes”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr) në “Fusha e sigurisë dhe e mbrojtjes”.

2. Programi i studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, zgjat të paktën 3 vite akademike dhe përfshin 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Programi i studimeve të fillojë në vitin akademik 2011-2012 dhe brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të ketë plotësuar kushtet këtu bashkëlidhur.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” e Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj